



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN080520240005

Tiranë, më: 17.07.2024

Komisioni 90

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person Juridik: “TERRAOIL SWISS” Sh.a

Nr. NIPT-i: L11725004I

Adresa e selisë: Rruga “Ismail Qemali”, Kulla Fratari, Nr.27, Ap 8-A, Tiranë.

Personi përgjegjës: Shefqet Dizdari

Për të zhvilluar projektin: **“SHTIM I PUSEVE TË RINJË DHE ASGJESIM I MBETJEVE TË RREZIKSHME”**.

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 14. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare, ku masa e nxjerrë e tejkalon nivelin prej 50 tonë/ditë në rastin e naftës dhe 10 000 m³/ditë në rastin e gazit.

Vendndodhja: Vendburimi i naftës, Visokë, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqja = 4656 ha

Kapaciteti i parashikuar për cdo pus do të jetë 1 deri 2 ton në ditë

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin I me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit,)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: Referuar kërkesës së subjektit “TerraOil Swiss” sh.a. me nr AN080520240005 aplikimi, datë 08/05/2024 në lidhje me kërkesën për Deklaratë Mjedisore për procedurën e thelluar të VNM-së për projektin “Shtim i puseve të rinjë dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme”, me vendodhje në Fier”, bazuar në pikën 11, të Kreut II, të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet me rekomandimet si më poshtë vijon:
- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e cilësisë së ajrit në mjedis, sugjerohet që si gjatë fazës së punimeve edhe gjatë shfrytëzimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:
 - Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
 - Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i ndërtimit dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
 - Të sigurohen struktura brenda sheshit të ndërtimit për larjen dhe pastrimin e automjeteve/rrotave të automjeteve, para daljes nga sheshi i ndërtimit, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”. Gjithashtu gjatë funksionimit të aktivitetit duhet të bëhet monitorim periodik i cilësisë së ajrit.
- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që si gjatë fazës së punimeve edhe gjatë fazës së shfrytëzimit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:
 - Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Menaxhimi i kimikateve”;
 - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, duhet të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKMsë nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”);

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, duhet të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Menaxhimi i kimikateve”.

- Në zbatim të legjislationit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike rekomandohet të bëhet rehabilitimi i sipërfaqeve të zhveshura nga bimësia duke krijuar hapësira të gjelbra përreth.

- Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese sugjeron që zhvilluesi duhet të përmbushë detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve, si më poshtë vijon:

- Gjatë zhvillimit të aktivitetit mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

- Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.

- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.

- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

- Drejtoria e Natyrës dhe e Pyjeve sugjeron si më poshtë vijon:

Spektori i pyjeve vlerëson se:

- Mungon pershkrimi e forma e përdorimit të sipërfaqeve që do përdoren nga projekti;

- Nëse këto sipërfaqe janë me formë përdorimi pyll/kullotë,

Spektori i Pyjeve dhe Kullotave shprehet kundër dhënies së lejes mjedisore, derisa nga bashkia dhe strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki të shprehen për këtë projekt.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura: Bazuar në dokumentacionin dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Shtim i puseve të rinj dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme”, me vendndodhje në fushën naftë mbajtëse Visokë, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, me zhvillues “TerraOil Swiss” dhe aplikues “GR ALBANIA”, me nr. Aplikimi AN080520240005, rezulton se brenda zonës ku do të zhvillohet projekti, ndodhen monumentet natyrorë “Rrepet e Peshkëpiajve” dhe

Rrapi i Zhurit”, shpallur me VKM-në nr. 187, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa”, të VKM nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”, por referuar koordinatave të vendosura në dokumentacion për puse të rinj, rezulton se këto puse nuk prekin sipërfaqen e monumenteve natyrorë.

Përsa më sipër kërkohet nga subjekti zhvillues që gjatë zhvillimit të projektit, të bëhet kujdes të mos cenohen monumentet natyrorë.

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehen: Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve për dhënien e mendimit për VNM u mbështet në Ligjin Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligji Nr.10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqinë, në Subjektin: “Terra Swiss” sh.a. ku do të zhvillohet Aktiviteti: “Shtim i puseve të rinjë dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme”, me Vendodhje: Vendburimi i naftës, Visokë, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.

Subjekti “Terra Oil Swiss” sh.a e ushtron aktivitetin e nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror në vendburimin Visokë, Fier në bazë të marrëveshjes koncesionare të lidhur mes IEC VISOKA, TRANSOILGROUP dhe ALBPETROL sh.a më 27.05.2011. Subjekti ka në administrimin e tij rreth 200 puse shpimi ku jo të gjithë janë aktivë. Puset e rinjë që do të shtohen janë puse ekzistuese, të hapur në vitet 2014-2015 nuk do të kete asnjë lloj ndërtimi të ri të gjitha proceset e punës janë ekzistuese dhe në gjëndje pune. Subjekti bën nxjerrjen e naftës, dekantimin e saj, kalimin në separator ku bëhet e mundur ndarja e ujit nga nafta. Nga përpunimi i kësaj sasive fluidi prodhohen rreth 2000 ton naftë bruto në muaj. E gjithë sasia e produktit të gatshëm magazinohet në depot e vecanta nga ku i livrohet subjekteve të kontraktuara nga Albpetrol sh.a (si detyrim nënatyrë bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure për termat “prodhim paraekzistues” dhe Pjesa e Prodhimit të Albpetrol”). Pra nga sa me sipër Terra Oil Swiss do të bëjë asgjësim të ujerave, ku pasi ujerat mbërrijnë në aktivitet nga subjektet gjeneruese të cilat do të bëjnë edhe transportin, pas një mini trajtimi që do i bëhet ujit kur është nevoja në minirafinerië që subjekti disponon dhe e ka në lejen e mjedisit, ujë do të injektohet në puse kurse pjesa tjetër duke qënë se është me produktet naftë do të përdoret si lëndë djegëse, dhe në këtë mënyrë themi që është një proces i cili nuk gjeneron mbetje. Gjithë procesi i ngarkimit, transportit, trajtimit dhe injektimit të ujit në vendburimin e Visokës është proces i mbyllur dhe i kontrolluar duke mos patur asnjë ndikim negativ në mjedisin ku kryhet. Si pus injektimi për ujrë teknologjik që prej 20 vitesh kashërbyer pusi G-622, i cili është pusi i parë i shpuar në vendburimin e Visokës dhe që ka dalë nga fondi i puseve aktiv. Pas marrjes së vendburimit me koncesion nga kompania Terra Oil Swiss është përshtatur si pus injektimi edhe pusi TOG-3 horizontal i shpuar në vitin 2014 nga Terra Oil Swiss.

Sugjerime:

Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri në secilin prej shesheve të puseve të nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror.

Të merren masat e nevojshme që mbetjet e rrezikshme të gjeneruara nga proceset e nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror, të ruhen në depozita të padepërtueshme dhe të bëhet grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi përfundimtar i tyre nga operatorë të licensuar.

Të zbatohen normat kufi të shkarkimeve, referuar VKM Nr.435, datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimit në ajër në Republikën e Shqipërisë”.

Të gjitha vendet dhe proceset në të cilët kemi emetime të gazrave në atmosferë të pajisen me sistemin e kapjes dhe tajtimit të gazeve të dëmshëm. Makineritë, instalimet të cilat kryejnë shkarkime të gazrave të pajisen me filtra për kapjen e gazrave dhe të ndërrohen vazhdimisht.

Të zbatohen vlerat kufi të shkarkimeve në mjediset ujore pritëse, referuar VKM Nr.177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.

Ujërat teknologjikë të gjeneruara nga instalimet për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror në Vendburimin e naftës Visokë, të grumbullohen dhe të trajtohen brenda normave të lejuara si dhe të bëhet monitorimi periodikisht dhe analizat e ujërave të trajtuara para shkarkimit në mjediset ujore pritëse.

Ujërat më përmbajtje të lëndëve të rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe asgjësohen nga subjekte të licensuara.

Të merren masa për mbrojtjen e tokës dhe ujërave nëntokësore duke bërë testimin e shtersave të papërshkueshmërisë.

Mbetjet e larguara nga vendndodhja për asgjësim/trajtim duhet të transportohen nga kontraktor të autorizuar.

Të merren të gjitha masat e nevojshme për grumbullimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve të gjeneruara nga operacionet e nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror. Mbetjet e rrezikshme të grumbullohen transportohen dhe asgjësohen në bazë të rregullave të VKM Nr.371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.

Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës referuar Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.

Të monitorohet secili prej shesheve dhe puseve aktivë të nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror.

Të monitorohen dhe mirëmbahen pajisjet, makineritë dhe instalimet për të evituar korrozionin e tyre dhe bërjen shkak për incidente dhe rrjedhje aksidentale të rrezikshme.

Të merren të gjitha masat e nevojshme për çmontimin e të gjitha pajisjeve instalimeve/makinerive, izolimin përfundimtar dhe rehabilitimin e zonës së puseve.

Bashkia Mallakaster: Bashkia Mallakastër jep mendim pozitiv për aktivitetin "Shtim i puseve të rinj dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme", të shoqërisë "TerraOil Swiss" Sha, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U zhvillua në dt.30.04.2024. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

- **Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.90, datë 27.01.2019 “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbureve me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Visokë, ndërmjet ALBPETROL Sh.a dhe IEC VISOKA, INC.**
- **Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.**
- **Mendimin e Drejtorive Teknike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.**
- **Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.**
- **Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 90, datë 17.07.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.106, datë 19.05.2022, "Një ndryshim në Urdhërin nr.75, datë 13.04.2022, për**

“Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3 Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga institucionet përkatëse. Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.4 Ndalohen rreptësisht punimet në zonat e mbrojtura
- 4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zonat me status të vecantë.
- 4.6 Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë me monumentet e natyrës të cilt ndodhen në zonë.
- 4.7 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- 4.8 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.9 Subjekti të zbatohet me korrektësi kërkesat e Legjislacionit Shqipëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe komunitetit.
- 4.10 Para fillimit të zbatimit të projektit në terren, të hartohet Plani i Menaxhimit Mjedisor.
- 4.11 Kompania të ndjek me përpikmëri projektin për të evituar rrëshkitjet e dherave dhe aksidentet e mundshme.
- 4.12 Proçesi teknologjik të kryhet në bazë të studimeve gjeologjike dhe hidrologjike për të shmangur në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijimin e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin e zonave përreth.
- 4.13 Proçesi i shpimit të pusit të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe objekteve të tjera në afërsi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësjellesi kanale etj.
- 4.14 Ndalohet kategorikisht shkarkimi i mbetjeve në shtratin e lumit në rast se gjenerohen te tilla.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.15 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore
- 4.16 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.17 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.18 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.

- 4.19 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.20 Të sistemohen brenda sipërfaqjes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës
- 4.21 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.22 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.23 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.24 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.25 Subjekti zhvillues që gjatë zhvillimit të projektit, të bëhet kujdes të mos cenohen monumentet natyrore.
- 4.26 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.27 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 4.28 **Të rehabilitohet sheshi i zonës së zhvillimit të projektit në përfundim të jetëgjatësisë së tij.**
- 4.29 **Zhvilluesi duhet të ketë në vëmendje të vecante respektimin e Ligjin Nr. 131/2014 "Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, në rast se do të preken toka bujqësore nga zhvillimi i projektit.**
- 4.30 **Të hartohet plani i masave që do të merren me qëllim ruajtjen e karakteristikave të mikroklimës së zones, e cila mund të çenohet nga zhvillimi i aktivitetit.**
- 4.31 **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar.**
- 4.32 **Shoqëria duhet të aplikojë nëpërmjet portalit on-line e-Albania, "Aplikim për përdorim burimi ujor" për shkarkimin e ujërave të ndotur.**

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Neni 25/1 "Monitorimi dhe vlefshmëria", zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara" dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.

- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona në hyrje të kantierit	55	45	19.01.2025	Çdo 6 muaj
Kantier ndërtimi	55	45	19.01.2025	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban më i afert me kantierin	55	45	19.01.2025	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marrë masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	19.01.2025	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	19.01.2025	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	19.01.2025	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta me koordinatat.



WGS84 UTM 34N

NR	X(EAST)	Y(NORTH)
1	386700.482	4501451.937
2	386728.924	4501543.218
3	386789.117	4501684.771
4	386917.440	4501678.156
5	387096.035	4501683.448
6	387100.665	4501549.171
7	387109.264	4501418.864
8	386965.727	4501333.535
9	386840.050	4501253.499
10	386772.581	4501351.395

KRGJSH

NR	X(EAST)	Y(NORTH)
1	471227.594	4502445.133
2	471255.004	4502536.755
3	471313.598	4502679.019
4	471442.020	4502673.863
5	471620.588	4502681.187
6	471626.747	4502546.938
7	471636.829	4502416.704
8	471494.236	4502329.727
9	471369.446	4502248.245
10	471300.851	4502345.392

GAUSS KRUGER ZONE 4

NR	X(EAST)	Y(NORTH)
1	4386785.981	4503388.925
2	4386814.436	4503480.244
3	4386874.653	4503621.853
4	4387003.028	4503615.236
5	4387181.694	4503620.530
6	4387186.327	4503486.199
7	4387194.929	4503355.839
8	4387051.334	4503270.476
9	4386925.606	4503190.407
10	4386858.110	4503288.343

Nr. pusi	X	Y
TOG1	4502680,00	4388765,00
TOG10	4502702,40	4388672,00
TOG19	4500951.600	4390748,00
TOG2	4502684,30	4388680,00
TOG20	4500962,03	4390742,80
TOG21	4500968,97	4390741,75
TOG22	4500968,56	4390726,77
TOG3	4502683,60	4388690,00
TOG4	4502681,00	4388694,50
TOG5	4502686,50	4388660,30
TOG8	4502700,80	4388682,00
TOG9	4502699,20	4388692,00
G14/b	4503283,86	4387385,94
G126/b	4502162,00	4389806,00